

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-159/2015

**Prishtinë,
11 tetor 2017**

Në çështjen juridike të:

Z.J.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Shukri Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA33632), të datës 13 mars 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 11 tetor 2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga Z. J. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numër KPA33632, refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/A/228/2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numër KPA33632, vërtetohet.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 10 maj 2007, Z. J. (tani e tutje: “pala ankuese”) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (tani e tutje: AKP) duke kërkuar vërtetimin e të drejtave pronësore dhe ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr. 245, tokë e kultivuar në sipërfaqe prej 00.02.50 ha, e cila gjendet në vendin e quajtur Carakofc, Komuna e Kamenicës (tani e tutje: prona e kërkuar).
2. Pala ankuese ka deklaruar se e ka blerë pronën e kërkuar nga S. A., por pasi të gjitha dokumentet i janë djegur gjatë konfliktit, ai e posedon vetëm deklaratën e dëshmitarit si dokument.
3. Në mbështetje të kërkesës së tij, pala ankuese i ka dorëzuar AKP-së këto dokumente:
 - Deklaratën e dëshmitarit nr. 4297/07 e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Mladenovc më 30 prill 2007, ku R.T. dhe M.J. dëshmojnë që Z. J. e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 1989.
4. Njoftimi i pronës është bërë më 28 tetor 2008. Prona e kërkuar është gjetur të jetë e zënë nga persona të panjohur, sidoqoftë, kërkesa është konsideruar si jokontestuese nga Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së pasi që asnjë palë nuk ka paraqitur përgjigje brenda afatit prej 30 ditësh sipas nenit 10.2 të Ligjit Nr. 03/L-079.
5. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së sipas detyrës zyrtare ka gjetur dy fleta poseduese të cilat tregojnë se ngastra kadastrale nr. 245 është gjetur e ndarë në 2 (dy) pjesë të cilat janë të regjistruara në emër të personave të tretë. Përkatësisht, në fletën poseduese nr. 27 figuron

ngastra kadastrale nr. 245/1, tokë e kultivuar me sipërfaqe prej 00.05.31 ha, e cila gjendet në vendin e quajtur Carakofc, e regjistruar në emër të B. D., kurse në fletën poseduese nr. 49 figuron ngastra kadastrale nr. 245/2, tokë e kultivuar me sipërfaqe prej 00.07.30 ha, e cila gjendet në vendin e quajtur Carakofc, e regjistruar në emër të Z. T. Të dy fletat poseduese janë lëshuar më 1 gusht 2008 nga Komuna e Kamenicës, Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë.

6. Pala ankuese është kontaktuar nga Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së dhe është këshilluar që të paraqesë prova shtesë për ta vërtetuar të drejtën e tij sepse dokumenti të cilin tashmë e ka paraqitur nuk i mbështet të drejtat e tij mbi pronën e kërkuar. Si një përpjekje shtesë, Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së i ka dërguar palës ankuese një letër njoftuese duke i kërkuar atij të t'i paraqes dokumentet dhe duke e njoftuar se nëse nuk e bën këtë, kërkesa mund të refuzohet nga Komisioni. Letra është pranuar nga pala ankuese më 21 nëntor 2013, sidoqoftë, ai nuk reagoi ndaj letrës.
7. Më 13 mars 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës e ka refuzuar kërkesën me anë të vendimit KPCC/D/A/228/2014, me arsyetimin se pala ankuese ka dështuar që të tregojë pronësinë ose ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë konfliktit 1998-1999.
8. Më 23 dhjetor 2014, palës ankuese i është dorëzuar vendimi. Ai ka paraqitur ankesë më 22 janar 2015.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKKPK-së përmban vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve dhe zbatim të gabuar të ligjit material dhe të procedurës.
10. Pala ankuese insiston se e ka blerë pronën e kërkuar më 1989, por të gjitha dokumentet e tij janë djegur për shkak të rrethanave të vitit 1998-1999. Pala ankuese ka dorëzuar deklaratën e dëshmitarit e cila është vërtetuar nga zyrtarët e Komunës së Mladenovcit, mirëpo Komisionin nuk i ka konsideruar deklarata relevante, gjë që sipas palës ankuese është gabim.
11. Në bazë të kësaj, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që t'ia pranojë ankesën si të bazuar dhe t'ia vërtetojë të drejtat pronësore dhe të drejtën e ri-posedimit mbi pronën e kërkuar në favor të tij.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

12. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç është paraparë me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079, dhe është e pranueshme.

Meritat e ankesës

13. Gjykata Supreme e Kosovës e ka shqyrtuar ankesën në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit për procedurën kontestimore nr. 03/L-006 (tani e tutje: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese ka gjetur se ankesa është e pabazuar.
14. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga KKPK-ja për ri posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës “dëshmon” të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, por gjithashtu dëshmon se ai nuk është në gjendje ta ushtojë të drejtën e tillë pronësore për shkak të rrethanave të lidhura drejtpërsëdrejti me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
15. Sipas kësaj dispozite ligjore, pala ankuese është dashur të paraqes prova për ta dëshmuar të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme.
16. KKPK-ja e ka bazuar vendimin e saj në faktin se pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë provë e cila do të mund të verifikohej nga AKP-ja, se ai si bartës i së drejtës pronësore gëzon të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar. Për më tepër, Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së sipas detyrës zyrtare nuk ka marrë prova të tilla. Kjo për shkak se Sekretariati, përkundër përpjekjeve të tij, kishte bërë verifikim negativ të fletave poseduese të cilat janë marrë sipas detyrës zyrtare.
17. Pala ankuese ka deklaruar se e ka blerë pronën, por dokumentet i janë djegur dhe se të vetmen provë të cilën mund ta paraqes është deklaratat e dy dëshmitarëve të cilët deklarojnë të njëjtën gjë.

18. Vetëm deklarata e dëshmitarit, pa asnjë provë mbështetëse nuk është dokument i mjaftueshëm për të vërtetuar të drejtën thelbësore siç është e drejta pronësore. Aq më tepër, kur pretendimi i palës ankuese nuk është vërtetuar nga Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së.
19. Ankesa e palës ankuese përsërit saktësisht të njëjtat pretendime të cilat i ka theksuar para KKPK-së. Asnjë provë e re nuk është ofruar me ankesë.
20. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë, bazuar në një procedurë të plotë dhe korrekte.
21. Në bazë të asaj që u tha më lart, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Shukri Sylejmani, Gjyqtar

Timo Eljas Torkko, Referente i EULEX-it